



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1444 Prot.

Tiranë, më datë 17.11.2023

VENDIM  
Nr. 578, datë 17.11.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, ndryshuar me Vendim Nr. 329, 02.06.2021, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.11.2023:

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e kërkesës së **Z. Erdal Çeçen** për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale, për nënkategoritë për të cilat ka aplikuar (P/A/1; P/A/2; P/A/3; P/A/4; P/A/5; P/A/6; P/A/7), pasi nuk plotëson numrin e projekteve të depozituara në konservim/restaurim, si autor/bashkëautor në secilën nënkategori;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

KRYETAR  
EINA MARGARETI

